



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 21, datë 16.03.2022

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË NDËRTIMIT TË OBJEKTIT:
“OBJEKT ME FUNKSION HOTEL 8 KATE MBI TOKË DHE 2 KATE PARKIM
NËNTOKË “WAVE HOTEL”, BASHKIA DURRËS”

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; nenit 17, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “LTD Co” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit të objektit: “Objekt me funksion hotel 8 kate mbi tokë dhe 2 kate parkim nëntokë “Wave Hotel”, Bashkia Durrës”, me subjekt zhvillues shoqërinë “LTD Co” sh.p.k, miratuar me Vendimin Nr. 37, datë 28.12.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 37, datë 28.12.2020, zëvendësohen me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

